



**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Funë ja Përgjithshme Administrativë
<b>Kryetari i Komunës</b>
01. Nr. / 113/01 - 976A
Ditë/da 16.01.2018
Gjakova - Djakovica - Gjakova

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimin:

**NISMËN**  
**PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN**  
**FORT DODGE**

NË FUSHËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE, EKONOMISË, KULTURËS DHE ARSIMIT

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me komunën e **Fort Dodge, Iowa USA**;
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e zhvillimit të administratës publike, ekonomisë, kulturës dhe arsimit, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e administratës publike, kulturës, ekonomisë dhe arsimit. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëja reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik;
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës;
4. **Arsyetimi** - Nisma për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën Fort Dodge nga shteti Iowa USA, bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy Komunave në fushën e administratës publike, kulturës, ekonomisë dhe arsimit. Si dhe për të fuqizuar dhe legjitimuar marrëveshjen ekzistuese të nënshkruar nga dy kryetarët e Komunave në vitin 2016.



# MBËSHTJELLËSI I LËNDËS

Formulari-nr. 13

Akti - lënda lihet A.A .....

16.04.18

Shenja e klasifikimit .....

01 - 413/01 - 8761

LËNDA: KRYETARI I KK - GAKOVË - Z. ARDIAN GJINI

BASHKPUÑIR NDËRKOMUNAC - FORT DODGE

Lëndët e zgjidhura njëkohësisht nr.....

Afati i ruajtjes: .....

Numri nga libri intern i dorëzimit .....

Për evidencën sipas LPA

- | PO - JO |
|---------|
| 1       |
| 2       |
| 3       |
| 4       |
| 5       |
| 6       |
| 7       |
| 8       |
| 9       |
| 10      |
| 11      |
| 12      |
| 13      |
| 14      |
| 15      |
| 16      |

Afati:


Përpunoj

..... 201..... Viti .....

(Vendi)

..... (Nënshkrimi)



**MARRËVESHJE BINJAKËZIMI  
NË MESË TË  
QYTETIT TË FORT DODGE  
(IOWA, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKES)  
DHE QYTETIT TË GJAKOVËS (REPUBLIKA E KOSOVES)**

Kryetari i Qytetit së Fort Dodge

dhe Kryetarja e Qytetit së Gjakovës

- Duke u bazuar në lidhjet ekzistuese të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetit të Fort Dodge dhe qytetit të Gjakovoës, të referuara si Palët;
- Duke u bazuar në besimin se forcimi i dialogut ndërmjet këtyre Qyteteve është një hap fundamental drejtë një zhvillimi dhe promovimin e lidhjeve ekonomike, akademike dhe kulturore ndërmjet palëve.

Në këtë mënyrë dakordohemi të bashkëpunojmë për këto tema:

**Bashkëpunimi në Fushën e Zhvillimit të Qytetit;**

Të dyja palët angazhohen që të inkurajojnë projektet e pëerbashkëta që në fokus kryesor i kanë këto fusha:

- Trashëgimitë Kulturore
- Qeverisjen elektronike dhe digjitalizimin a administratës publike

Të dyja palët do të angazhohen që të shkëmbejnë eksperiencat dhe teknologjitet e tyre, që vijnë si falendërim i misioneve teknike të udhëhequra nga ekpertët që punojnë në këto fusha kryesore dhe në projektet tjera të pëerbashkëta.

**Bashkëpunimi Kulturor;**

Të dy palët do të bashkëpunojnë në promovimin dhe do ti udheëheqin të gjitha aktivitetet që do të lehtësoj shkëmbimet ndërmjet organizatave kulturore të të dyja palëve.

## Bashkëpunimi Ekonomik;

Të dy palët, përmes bordeve ekonomike në detyrë, do ti mbështesin dhe forcojnë bashkëpunimet në promovim të tregtisë dhe të zhvillimit ekonomik ndërmjet ndërmarjeve të të dyja qyteteve.

## Bashkëpunimi Akademik;

Të dyja palët dëshirojnë që të promovojnë miqësi internationale duke i stimuluar dhe zhvilluar aktivitetet ndërkulturore dhe projektet ndërmjet te rinjëve dhe studentëve të Gjakovës dhe Fort Dodge. Në këtë kontekst, qyteti i Gjakovës dhe Qyteti i Fort Dodge do ti mbështesin transferimin e studentëve, profesorëve dhe internshipëve nga universitetet dhe qendrat tjera hulumtuese të Gjakovës dhe Fort Dodge.

Marrëveshja e bashkëpunimit do të kryhet në përputhje me ligjet në fuqi të të dyja vendeve në bazë të detyrimeve pëerkatëse që merren nga të dyja palë sipas të drejtës ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e tyre në grupime rajonale dhe ndërkombetare.

Të dyja palët deklarojnë se çdo aktivitet që synon zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nuk do të implikon pagesa shtesë nga sistemi publik i financave, duke u bazuar në ligjin publik finanziar një fuqi, por do të mbulohen nga institucionet e propozuara.

Kjo Marrëveshje bashkepunimi do të hyn në fuqi në datën e nënshkrimit. Dispozitat e saj mund të ndryshohen me kërkesë të secilës palë dhe do ti ndjekë procedurat e marra përsipër nga ligji kombëtar.

### Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje do të hyn në fuqi prej dhe nga (muaji, dita, 2016) deri me (muaji, dita, 2026) në dy kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe dhe Angleze dhe tekstet të janë njëlloj autentike.

Në rast të mosmarrëveshjes se palëve në interpretim, teksti në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

### PËR QYTETIN E FORT DODGE

IOWA, SHBA

Matt Bemrich

Kryetar i Fort Dodge




### PËR QYTETIN E GJAKOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS

Mimoza Kusari-Lila

Kryetare e Gjakovës





Kryesuesi i Komunës

01 Nr. \_\_\_\_\_

Dt. \_\_\_\_\_

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal, Kuvendi i Komunës së Gjakovës, miraton:

### VENDIM

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal;
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunën e Fort Dodge nga Iwoa USA;
3. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal;
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala